VENDIM
Nr.18, datë 13.1.1997

PËR PROKURIMIN ME FONDE SHTETËRORE PËR PRODHIMIN E KALEMAVE TË KULTIVARËVE AUTOKTONË TË VRESHTARISË

Në mbështetje të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", neni 17 pika 3, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit që, nëpërmjet Institutit të Pemëtarisë në Vlorë, të prokurojë drejtpërdrejt shumën prej 7 milionë lekësh, miratuar nga Këshilli i Ministrave për grumbullimin dhe përgatitjen e kalemave nga kultivarët autoktonë të vreshtarisë shqiptare.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi